

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI I GJEOSHKENCAVE

DEPARTAMENTI: GJEOLGJISË



PUNIM MASTERI

LINDRIT KRASNIQI

Mitrovicë, 2020

**UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”
FAKULTETI I GJEOSHKENCAVE
DEPARTAMENTI: GJEOLGJISË
PROGRAMI: HIDROGJEOLGJI ME GJEOLGJI
INXHINIERIKE**



**PËRCAKTIMI I KUSHTEVE GJEOLGO – INXHINIERIKE
TË TRUALLIT PËR NDËRTIMIN E STADIUMIT
NACIONAL NË DRENAS**

Kandidati:

BSc. Lindrit Krasniqi

Mentori:

Prof. Dr. Zenun Elezaj

Mitrovicë, 2020

**UNIVERSITY OF MITROVICA “ISA BOLETINI”
FACULTY OF GEOSCIENCES
DEPARTAMENT: GEOLOGY
PROGRAM: HIDROGEOLOGY WITH
ENGINEERING GEOLOGY**



**DETERMINATION OF GEOLOGICAL ENGINEERING
CONDITIONS OF THE FIELD FOR THE CONSTRUCTION
OF THE NATIONAL STADIUM IN DRENAS**

Candidate:

BSc. Lindrit Krasniqi

Mentor:

Prof. Dr. Zenun Elezaj

Mitrovica, 2020

ABSTRAKT

Ky punim masteri është hartuar në harmoni me statusin e fakultetit të gjeoshkencave dhe me plan – programin e departamentit të gjeologjisë në Mitrovicë. Studimi i zonës së planifikuar për ndërtimin e stadiumit nacional të Kosovës, në kaudrin e gjeologjisë inxhinerike u realizua në bashkëpunim me laboratorin e gjeoteknikës “Geokos A&A”.

Objekti i këtij punimi është të shqyrtoj çështjet e mëposhtme të cilat do të jenë të mbështetura në punimet gjeologo - inxhinerike. Do të rishikohen të gjitha punimet e mëparshme gjeologjike të kryera nga autorë të tjerë vendas të cilat janë kryer për qëllime të tjera por që kanë vlera njohëse. Do të shqyrtohen të gjitha studimet e botuara dhe të pa botuara për zonën në fjalë.

Për të realizuar këtë studim kam gërshetuar rezultatet e shpimeve hulumtuese, rezultatet e provave „in situ”, rezultatet e shqyrtimeve laboratorike, rezultatet e studimit seizmik me metodën e valëve të thyera, profilet litologjike dhe konsultimin e hartave të ndryshme si atë: gjeologjike, hidrogeologjike, tektonike dhe nxitimit sizmik, pastaj të erozionit dhe atë të klimës së zonës në fjalë.

Bazuar në punimet gjeologo – zbuluese të lartë cekura, studimi është fokusuar në vlerësimin dhe përcaktimin e kushteve gjeologo – inxhinerike të zonës së studiuar, pra për të nxjerrur në pah: përbërjen, shtrirjen dhe vetitë fiziko – mekanike të formacioneve gjeologjike që përbëjnë zonën e studiuar, ndërsa analizat e aftësive mbajtëse dhe e uljeve janë bazuar në të dhënat laboratorike.

Pasi që terreni i hulumtuar ka sipërfaqe të madhe, gjatë procesit të projektimit, modeli gjeoteknik duhet të merret nga shpimet hulumtuese, testet CPTu dhe SPT që korrespondojnë me lokacionin e strukturës së propozuar.

Fjalët kyçe: Stadiumi nacional, gjeologo – inxhinerike, shpimet hulumtuese, vetitë fiziko – mekanike, aftësia mbajtëse dhe uljet.

ABSTRACT

This master thesis was drafted in accordance with the status of the faculty of geosciences and the curriculum of the department of geology in Mitrovica. The study of the area planned for the construction of the national stadium of Kosovo, in the framework of engineering geology was made in cooperation with the geotechnical laboratory "Geokos A&A".

The objective of this master thesis is to examine the following issues which will be based on geological - engineering works. All previous geological works carried out by other local authors which have been carried out for other purposes but which have cognitive values, will be reviewed. All published and unpublished studies for this area, will be reviewed.

To conduct this study, i have combined the results of research drilling, test results "in situ", the results of laboratory tests, results of seismic study with the method of broken waves, lithological profiles and consultation of various maps such as that: geological, hydrogeological, tectonic and seismic acceleration, then the erosion and climate map of the area in question.

Based on the above mentioned geological - exploratory works, the study is focused on the assessment and determination of geological - engineering conditions of the studied area, so to highlight: the composition, extent and physico - mechanical properties of the geological formations that make up the studied area, while the analysis of bearing capacity and reductions are based on laboratory data.

Since the surveyed terrain has a large surface area, during the design process, the geotechnical model should be taken from the research drilling, CPTu and SPT tests corresponding to the location of the proposed structure.

Keywords: *National stadium, geological - engineering, research drilling, physical - mechanical properties, bearing capacity and settlements.*

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT	3
ABSTRACT	4
PËRMBAJTJA	5
REGJISTËR I FIGURAVE	7
REGJISTËR I TABELAVE	8
REGJISTËR I FOTOGRAFIVE	9
REGJISTËR I SHKURTIMEVE	9
HYRJE.....	10
1.0. POZITA GJEOGRAFIKE	12
1.1. Tiparet Gjeomorfologjike	13
1.2. Karakteristikat klimatike.....	14
1.2.1. Temperaturat e Ajrit	15
1.2.2. Avullimi.....	16
1.2.3. Reshjet	16
1.4. Proceset Fiziko – Gjeologjike.....	17
2.0. NDËRTIMI GJEOLIGO – TEKTONIK.....	19
2.1. Karakteristikat tektonike të Kosovës	21
2.1.2. Sizmiciteti i territorit të Kosovës.....	23
2.1.3. Karakteristikat e përgjithshme dhe kushtet mesatare të truallit në Kosovë.....	25
2.1.4. Rajonizimi sizmik i Kosovës.....	25
2.2. Përbërja Litostratigrafike e zonës	26
2.3. Kushtet hidrogjeologjike të zonës.....	29
3.0. PUNIMET GJEOLIGO – ZBULUESE	31
3.1. Qëllimi i punimeve gjeologo – zbuluese	31
3.2. Zhvillimi i punimeve gjeologo – zbuluese dhe kontrolli i tyre.....	31
3.3. Shpimet me rrotullim	32
3.3.1. Testi i penetrimit standard(SPT)	35
3.3.2. Kampion – marrja.....	36
3.3.3. Monitorimi i ujërave nëntokësorë	61
3.4. Testi penetrimit të konit me presion poror (CPTu).....	62

3.5. Egzekutimi i studimit seizmik me metodën e valëve të thyera.....	64
4.0. ANALIZAT LABORATORIKE.....	67
4.1. Qëllimi i analizave laboratorike.....	67
4.2. Analizat për përcaktimin e vetive fizike.....	67
4.3. Analizat për përcaktimin e vetive mekanike.....	71
5.0. KUSHTET GJEOLIGO-INXHINERIKE TË ZONËS.....	74
5.1. Rezultatet e fituara nga testet SPT.....	74
5.2. Rezultatet e fituara nga testet CPTu.....	76
5.3. Rezultatet e studimit seizmik me metodën e valëve të thyera.....	79
5.3.1. Të dhënat mbi goditjet.....	79
5.3.2. Profili 3-3 MASW.....	82
5.4. Modeli Gjeoteknik.....	85
6.0. LLOGARITJA E AFTËSISË MBAJTËSE DHE ULJEVE.....	92
6.1. Mbështjetet teorike mbi analizën e aftësive mbajtëse dhe uljeve.....	92
6.1.1. Aftësia mbajtëse kufitare e dherave.....	92
6.1.2. Uljet gjatë konsolidimit me pengim të zgjerimit anësorë (në edometër).....	93
6.1.3. Pikat karakteristike për të cilën llogariten uljet.....	94
6.2. Rezultatet e llogaritjeve dhe diskutime.....	95
6.3. Kushtet e fondimit, aftësia mbajtëse, uljet dhe koeficienti i reaksionit të dherave.....	96
7.0. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	100
LITERATURA.....	103

REGJISTËR I FIGURAVE

<i>Figura 1. Pozita gjeografike e Zonës së Studimit. L. Krasniqi 2020</i>	<i>13</i>
<i>Figura 2. Harta gjeomorfologjike e zonës së studimit</i>	<i>14</i>
<i>Figura 3. Variacioni i temperaturave mesatare, minimale dhe maksimale mujore.....</i>	<i>16</i>
<i>Figura 4. Variacioni i reshjeve mesatare mujore 1961-1990,</i>	<i>17</i>
<i>Figura 5. Harta e erozionit të Kosovës</i>	<i>18</i>
<i>Figura 6. Harta tektono - stratigrafike e Kosovës (Elezaj&Kodra, 2008).....</i>	<i>20</i>
<i>Figura 7. Harta e shkëputjeve neotektonike të Kosovës, (Elezaj&Kodra, 2008).....</i>	<i>22</i>
<i>Figura 8. Harta morfostrukture e Kosovës (Elezaj&Kodra, 2008).....</i>	<i>23</i>
<i>Figura 9. Harta e nxitimit maksimal në territorin e Kosovës. (Elezaj&Kodra, 2008)</i>	<i>24</i>
<i>Figura 10. Kontakti i llojeve të shkëmbinjëve nëpër të cilët lëvizin valët sizmike.</i>	<i>26</i>
<i>Figura 11. Harta gjeologjike e zonës, 1:100 000.....</i>	<i>28</i>
<i>Figura 12. Harta hidrogeologjike e zonës, 1:200 000</i>	<i>30</i>
<i>Figura 13. Situacioni me shpimet hulumtuese dhe testet CPTu mbi inqizimin topografik të zonës së studimit</i>	<i>33</i>
<i>Figura 14. Procedura e realizimit të testit SPT (Coduto-1994, 1994).....</i>	<i>35</i>
<i>Figura 15. Profili litologjik i shpimit, BH-1.....</i>	<i>39</i>
<i>Figura 16. Profili litologjik i shpimit, BH-2.....</i>	<i>41</i>
<i>Figura 17. Profili litologjik i shpimit, BH-3.....</i>	<i>43</i>
<i>Figura 18. Profili litologjik i shpimit, BH-4.....</i>	<i>45</i>
<i>Figura 19. Profili litologjik i shpimit, BH-5.....</i>	<i>47</i>
<i>Figura 20. Profili litologjik i shpimit, BH-6.....</i>	<i>49</i>
<i>Figura 21. Profili litologjik i shpimit, BH-7.....</i>	<i>51</i>
<i>Figura 22. Profili litologjik i shpimit, BH-8.....</i>	<i>53</i>
<i>Figura 23. Profili litologjik i shpimit, BH-9.....</i>	<i>55</i>
<i>Figura 24. Profili litologjik i shpimit, BH-10.....</i>	<i>57</i>
<i>Figura 25. Profili litologjik i shpimit, BH-11.....</i>	<i>59</i>
<i>Figura 26. Ilustrim i Konit me matje elektrike - S10-CFIIP</i>	<i>63</i>
<i>Figura 27. Paraqitja e lokacionit dhe profileve të matur në teren.....</i>	<i>65</i>
<i>Figura 28. Interpretimi i shtresave litologjike</i>	<i>80</i>
<i>Figura 29. Përhapja e shpejtësisë së valës.....</i>	<i>81</i>
<i>Figura 30. Gjurmët e valës.....</i>	<i>82</i>
<i>Figura 31. Përhapja e valës seizmike në tokë</i>	<i>84</i>
<i>Figura 32. Profili litologjik gjatësor, PRERJA I-I</i>	<i>89</i>
<i>Figura 33. Profili litologjik gjatësor, PRERJA II-II</i>	<i>90</i>
<i>Figura 34. Profili litologjik gjatësor, PRERJA III-III.....</i>	<i>91</i>
<i>Figura 35. Skema e pikave karakteristike të uljeve</i>	<i>95</i>
<i>Figura 36. Analiza e aftësisë mbajtëse, koeficientit të reaksionit dhe uljeve për SH-6</i>	<i>98</i>
<i>Figura 37. Analiza e aftësisë mbajtëse, koeficientit të reaksionit dhe uljeve për SH-6</i>	<i>99</i>

REGJISTËR I TABELAVE

Tabela 1. Distanca e zonës së studimit me qytetet tjera	12
Tabela 2. Vlerat mesatare mujore të temperaturave në stacionet përreth zonës së studimi	15
Tabela 3. Sasia e reshjeve në mm sipas muajve të vitit gjatë periudhës 1961 – 1990	17
Tabela 4. Emërtimi, koordinatat dhe data e realizimit të shpimeve hulumtuese	33
Tabela 5. Të dhënat mbi shpimet e realizuara	36
Tabela 6. Të dhënat mbi shpimet e realizuara	37
Tabela 7. Rezultatet e montorimi i ujërave nëntokësorë.....	61
Tabela 8. Karakteristikat e Konit të përdorur gjatë testimeve me CPTu	62
Tabela 9. Emërtimi, koordinatat, thellësia dhe data e realizimit të testeve CPT.....	64
Tabela 10. Të dhënat mbi profilet e realizuar me metodën e matjeve sezimike	64
Tabela 11. Parametrat fizik të përmbledhura	68
Tabela 12. Parametrat fizik të përmbledhura	69
Tabela 13. Rezultatet e Granulometrisë dhe attebergut.....	70
Tabela 14. Parametrat e konsolidimit	71
Tabela 15. Rezultatet e rezistencës në rrëshqitje	72
Tabela 16. Rezultatet nga shtypja njëaksiale dhe kohezioni në kushte të padrenuara	73
Tabela 17. Klasifikimi i dherave të palidhura në bazë të goditjeve të SPT sipas Terzaghit	74
Tabela 18. Klasifikimi i dherave të lidhura në bazë të goditjeve të SPT sipas Terzaghit ...	74
Tabela 19. Rezultatet e përmbledhura të testeve SPT	75
Tabela 20. Rezultatet e CPT-1.....	76
Tabela 21. Rezultatet e CPT-2.....	76
Tabela 22. Rezultatet e CPT-3.....	77
Tabela 23. Rezultatet e CPT-4.....	77
Tabela 24. Rezultatet e CPT-5.....	77
Tabela 25. Rezultatet e CPT-6.....	77
Tabela 26. Rezultatet e CPT-7.....	78
Tabela 27. Rezultatet e CPT-8.....	78
Tabela 28. Pozicionet e Gjeofoneve	79
Tabela 29. Pozicionimi i gjeofoneve dhe rezultatet e goditjeve	79
Tabela 30. Interpretimi me metodën (GRM)	81
Tabela 31. Parametrat Gjeoteknik	82
Tabela 32. Leximet e gjeofoneve	83
Tabela 33. Disa parametra tjerë gjeoteknik	84
Tabela 34. Parametrat gjeoteknik të shtresës nr.3	85
Tabela 35. Rezultatet për parametrat gjeoteknik të shtresës 4.....	86
Tabela 36. Rezultatet për parametrat gjeoteknik të shtresës 5.....	87
Tabela 37. Rezultatet për parametrat gjeoteknik të shtresës 6.....	88
Tabela 38. Llogaritja e aftësisë mbajtëse dhe uljeve.....	97

REGJISTËR I FOTOGRAFIVE

Foto 1. Detaj nga punimet në teren.....	32
Foto 2. Detaj nga punimet në teren, CMV - 420 S.....	34

REGJISTËR I SHKURTIMEVE

ASTM	American Society for Testing and Materials
BH	Emërtimi i shpimeve
c	Kohesioni
C_B	Diametri i shpimit
C_E	Shkalla e energjisë
CFIIP	Emri i konit(CPT)
CL	sipas klasifikimit USCS
C_R	Gjatësia e shurfave
Cu	Kohezioni ne kushte të padrenuara
EC7	EuroCode 7
EN ISO	European norm - International Organisation for Standardisation
GRM	Generalized Reciprocal method
In-Situ	Testimet në teren
MAE Srl	Emërtimi i paisjes(MASW)
MASW	Multichannel Analysis of Surface Waves
ML	sipas klasifikimit USCS
OCR	Over consolidation ratio
SC	sipas klasifikimit USCS
SM	sipas klasifikimit USCS
USCS	Unified Soil Classification System
UTM	Universal Transverse Mercator
φ(°)	Këndi i fërkimit të brendshëm.

HYRJE

Kushtet gjeologo – inxhinerike të trualit për ndërtimin e objekteve inxhinerike duke përfshirë edhe të stadiumeve mund të ndikojnë në përcaktimin e kostosë së objekteve, përkatësisht të kostosë së fondimit, prandaj nevojitet që të vlerësohet drejt mjedisi gjeologjik, sepse në njërin anë është objekti, konstruksioni dhe pikëpamja statike e dinamike se si punon ai, dhe në anën tjetër vlerësimi sa më cilësorë i vetive fiziko – mekanike të shkëmbinjëve që do të shërbejnë si bazament i tij.

Gjatë përcaktimit të vëllimit të punimeve gjeologo – inxhinerike për zonën ku parashihet ndërtimi i stadiumit nacional janë marr parasysh disa kritere: gabaritet e objektit, ngarkesa e objektit dhe mënyra e fondimit.

Realizimi i këtij punimi kaloi nëpër disa etapa studimi:

- Grumbullimi dhe analizimi i punimeve gjeologjike, hidrogjeologjike dhe gjeoteknike të realizuara në këtë zonë.
- Njohja dhe vrojtimet fushore gjeologjike, gjeomorfologjike dhe gjeoteknike.
- Realizimi i shpimeve hulumtuese (hatografimi dhe interpretimi gjeologjik, montiorimi i NUN, testet “In-situ” SPT dhe CPTu, pastaj realizimi i studimit seizmik me metodën e valëve të thyera dhe testi MASW.
- Analizat laboratorike mbi vetitë fiziko – mekanike të kampionave të marrur nga shpimet hulumtuese.
- Përpunimi, analizmi dhe interpretimi i rezultateve.

Përpunimi i materialit dhe interpretimi i analizave është realizuar me programet kompjuterike si: GEOsystem, ArcGIS, AutoCAD, Loadcap, EasyRefract, EasyMASW etj.

Studimi është organizuar në shtatë kapituj:

Në **kapitullin e parë**, jepen të dhëna mbi pozitën gjeografike dhe gjeomorfologjinë e zonës së studimit, jepen të dhëna gjithashtu mbi kushtet klimatike që mbizotërojnë, si dhe janë paraqitur proceset fiziko – gjeologjike që zhvillohen në këtë zonë.

Në **kapitullin e dytë**, është paraqitur ndërtimi gjeologo – tektonik dhe kushtet hidrogeologjike të zonës së studiuar. Në zonën e studimit përhapen shkëmbinjë të moshave të ndryshme duke filluar nga pararreshpet(filitet, rreshpet sericitike) të Paleozoikut të Sipërm, seria Vullkanogjeno – sedimentare, pastaj mika kuarcitet, Gëlqerorët silicorë të metamorfizuar, kuarcitet e amfibolitet e e Triasikut, pastaj Serpentinitet dhe Harcbugitet e serpentinizuara të Jurasikut (Masivi i Goleshit), gëlqerorët e Kretakut, depozitime të reja Miocene dhe pliocenike si dhe sedimentet e Pleistocenit dhe Holocenit të përfaqësuar nga argjilat, rërat dhe zhavoret.

Në **kapitullin e tretë**, janë paraqitur punimet gjeologo – zbuluese, ku janë përfshirë qëllimi, zhvillimi dhe rëndësia e tyre. Në fazën e punimeve gjeologo – zbuluese destinacion kryesor këto punime kanë pasur përcaktimin e karakteristikave të formacioneve gjeologjike në zonën e planifikuar për ndërtimin e stadiumit nacional. Marrja e kampioneve me strukturë të prishur dhe të paprishur për shqyrtim të mëtejme në laborator kanë qenë prioritet, pastaj rëndësi i është kushtuar testimeve “in-situ”: testit(SPT) dhe (CPTu). Në këtë fazë është realizuar edhe studimi seizmik me metodën e valëve të thyera.

Në **kapitullin e katërt**, janë paraqitur shqyrtimet laboratorike të mostrave të marruara nga terreni. Bazuar në profilin gjeologo – gjeoteknik të terrenit të ndërtuar pas punimeve gjeologo – zbuluese është përpiluar programi për shqyrtime laboratorike i cili është bazuar edhe në strukturën e kampioneve, pastaj nga vetitë dhe karakteristikat e shtresave të takuar dhe nga sasia e kampioneve për secilën shtresë, mënyrë kjo që të përfshihen të gjitha shtresat për shqyrtim. Testimet laboratorike përfshijnë testet e klasifikimit sipas metodave American Society for Testing and Materials (ASTM).

Në **kapitullin e pestë**, janë paraqitur kushtet gjeologo – inxhinerike të zonës për ndërtimin e stadiumit nacional ku, për evaluimin dhe caktimin e rezistencës në rrëshqitje, të deformimit, dhe vlerave përfaqësuese të shtresave, është përdorur kombinimi i përshkrimit gjeologjik të mostrave, rezultatet e testimeve “in-situ” (SPT dhe CPTu), rezultatet e testimeve laboratorike të mostrave dhe në bazë të këtyre parametrave është formuluar modeli gjeoteknik. Në **kapitullin e gjashtë**, janë llogaritur aftësia mbajtëse dhe uljet, ndërsa në **kapitullin shtatë**, janë prezantuar përfundimet dhe rekomandimet.

1.0. POZITA GJEOGRAFIKE

Zona e studimit, përkatësisht zona ku do të ndërtohet stadiumi nacional i Kosovës, së bashku me stadiumet e tjera dhe objektet përcjellse përfshin një sipërfaqe rreth 16 ha apo 160 000 m².

Zona e studimit ka një pozitë të përshtatshme gjeografike, sepse shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, dhe distanca me qendrat tjera të Kosovës i mundëson një qasje të përshtatshme për të gjithë, prandaj në tabelën më poshtë është paraqitur distanca e zonës ku do të ndërtohet stadiumi nacional i Kosovës me qendrat kryesore të Kosovës.

Tabela 1. Distanca e zonës së studimit me qytetet tjera

Qyteti	Zona e Studimit
	Distanca e zonës me qytetet
Prishtina	17 km
Prizreni	60 km
Peja	61 km
Mitrovica	50 km
Gjakova	65 km
Ferizaji	46 km
Podujeva	45 km

Lokacioni ku parashihet të ndërtohet stadiumi nacional i Kosovës, në aspektin administrativ i takon komunës së Drenasit, pra gjendet në kufi mes fshatit Korroticë e Epërme dhe fshatit Sankoc, përkatësisht përballë parkut të biznesit në Drenas, gjithashtu shtrihet përgjatë autostradës “Ibrahim Rugova” e cila e lidhë Prishtinën me kufirin me Shqipërinë.

Qasja e përshtatshme në autostradë, afërsia rreth 6 km me aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës, përbënë një avantazh për këtë projekt.

Në **Figurën 1**, është paraqitur harta e pozitës gjeografike të zonës së studimit.




Figura 1. Pozita gjeografike e Zonës së Studimit. L. Krasniqi 2020

1.1. Tiparet Gjeomorfologjike

Relievi i zonës së studimit por edhe i zonës përreth dallohet për karakterin e theksuar të trajtave kodrinore - malore, forma të larmishme, pjerrësi mesatare deri në të madhe të shpateve dhe larminë e tipeve morfogjenetike të tyre (Nuli, 2017). Evolucionin e dukurive gjeologjike dhe transformimet në reliev, që ka pësuar zona, janë rezultat i bashkëveprimit të ngushtë midis faktorëve të brendshëm (lëvizjet tektonike dhe neotektonike) dhe atyre të jashtëm (erozioni, rrëshqitjet etj) (Çadraku, 2014). Me një lartësi 700-715 metra mbi nivelin e detit, zona e studimit gjendet në mes të dy fushëgropave kryesore të Kosovës: asaj të rrafshit të Kosovës dhe rrafshit të Dukagjinit, gjë që vërehet edhe nga harta në figurën 2.




Figura 2. Harta gjeomorfologjike e zonës së studimit

1.2. Karakteristikat klimatike

Klima duhet vlerësuar si faktorë që ndikon në zhvillimin e proceseve fiziko – gjeologjike siç janë: rrëshqitjet e lidhura me ndikimin e klimës, prandaj vlerësimi i klimës për sigurimin e objekteve inxhinierike është shumë i rëndësishëm (Konomi, 2006). Në kuadrin e përgjithshëm klimatik të trevës së Kosovës ku përfshihet edhe zona e Drenicës, dhe së bashku edhe zona e studimit i përket klimës së mesme kontinentale, e lidhur ngushtë me pozitën kalimtare të shtrirjes së saj midis Fushës së Kosovës në lindje, e cila është relativisht më e thatë dhe më e ftohtë, kurse nga perëndimi hapet gjerësisht ndaj Rrafshit të Dukagjinit më të lagët në të gjithë shtrirjen territoriale të saj. Veçoritë klimatike të zonës janë përcaktuar nën veprimin e disa faktorëve, midis të cilëve pozita gjeografike, veçanërisht lartësia mbi nivelin e detit, drejtimi i kurrizeve kodrinore – malore, prania e grykave tërthore nga depërtojnë erërat e ardhura prej gadishullit Ballkanik dhe atyre nga deti Adriatik (Nuli, 2017).

1.2.1. Temperaturat e Ajrit

Regjimi i temperaturave në zonën e studimit paraqitet me ndryshime të dukshme, të cilat i detyrohen kushteve të një relievi kryesisht kodrinor me shtrirje afro meridionale, largësisë nga deti dhe nga disa veçori të tjera lokale. Zona e Drenicës përfshihet midis izotermave 11°C deri në 12°C , por mbizotëruese janë vlerat e temperaturave mesatare vjetore 11°C . Temperatura mesatare vjetore ndryshon nga 10.5°C në Drenas dhe Skënderaj 11°C . (Nuli, 2017). Më poshtë, në tabelën 2, janë paraqitur të dhëna të temperaturës së ajrit për disa vendmatje.

Tabela 2. Vlerat mesatare mujore të temperaturave në stacionet përreth zonës së studimit 1961-1990. ((ASK), 2011)

Stacioni	Muajt											
	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH
Skënderaj	-0.2	2.3	6.3	10.9	15.7	18.2	20.1	19.3	16.5	11.4	6.3	1.9
Drenas	-0.1	1.6	5.9	10.5	15.3	18.5	20.2	19.4	15.8	10.2	5.4	1.2
A. i Prishtinës	-1.3	1.1	5.0	9.9	14.7	17.8	19.2	19.3	15.9	10.6	5.1	0.4
Mes	-0.4	1.7	5.7	10.4	15.2	18.2	19.8	19.3	16.1	10.7	5.6	1.2
Min	-1.3	1.1	5.0	9.9	14.7	17.8	19.2	19.3	15.8	10.2	5.1	0.4
Max	-0.1	2.3	6.3	10.9	15.7	18.5	20.2	19.4	16.5	11.4	6.3	1.9

Nga të dhënat e tabelës vërehet se muaji më i ftohtë është janari me vlerë në Sllatinë - 1.3°C , në Skënderaj dhe Drenas përkatësisht - 0.2°C dhe -0.1°C , kurse muaji më i ngrohtë në pjesën më të madhe të Drenicës është korriku me 20.2°C , ku nga të dhënat e tabelës duket qartë se ndryshimi midis këtyre muajve është krejtësisht i papërfillshëm. Vlerat e dhëna të kësaj tabele dëshmojnë se temperaturat rriten lehtësisht nga lindja drejtë perëndimit, të cilat detyrohen drejtpërdrejtë ndikimit të masave ajrore të ngrohta të ardhura nga fusha grabenore ndërmallore e Rrafshit të Dukagjinit. (Nuli, 2017).




Figura 3. Variacioni i temperaturave mesatare, minimale dhe maksimale mujore 1961-1990

1.2.2. Avullimi

Avullimi është process i cili ndodh kudo në sipërfaqen e tokës, por intensiteti i tij është në varësi nga kushtet klimatike të një rajoni të caktuar. Avullimi në mënyrë direkte varet nga temperatura e sipërfaqes së tokës, nga lagështia e ajrit, shpejtësia e erës, shtypja atmosferike, sasia e reshjeve, relievi, pozita gjeografike, afërsia me ujërat nëntokësorë, mbulesa humusore etj. Sa më e madhe të jetë sipërfaqja aq më i madh është avullimi.

Nëse ajri është i ngopur me ujë, avullimi do të jetë i vogël, po ashtu me rritjen e presionit atmosferik zvogëlohet avullimi. Avullimi në terenet e mbuluara me vegjetacion është më i madh se në terenet pa vegjetacion. (Çadraku, 2014)

1.2.3. Reshjet

Shtrirja e zonë së Drenicës midis fushave grabenore ndërmallore të lartpërmendura dhe largësia nga deti kanë përcaktuar një regjim pluviometrik mesatar kontinental. Shpërndarja territoriale e vlerave mesatare të sasisë vjetore të reshjeve (600-800mm) për këtë zonë është pothuajse e njëjtë me atë të Kosovës (667mm). Në tabelën 3, është paraqitur sasia e reshjeve në zonën e Drenicës prandaj vërehet edhe nga tabela që, sasia më e madhe e reshjeve bie gjatë sektorit perëndimor të Drenicës me 747mm. (Nuli, 2017).

Tabela 3. Sasia e reshjeve në mm sipas muajve të vitit gjatë periudhës 1961 – 1990 (Nuli, 2017)

Stacioni	Muajt												Viti
	J	Sh	M	P	M	Q	K	G	Sh	T	N	D	
Prishtinë	35	35	34	51	72	73	47	43	48	54	62	51	605 mm
Skënderaj	59	49	53	67	79	67	61	49	51	52	91	69	747 mm
Drenas	58	46	44	52	63	65	57	41	47	53	79	62	667 mm

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme vërejmë se sasia më e madhe e reshjeve për të gjithë zonën takohet gjatë muajve Qeshor në zonën e Prishtinës. Kurse në Drenas dhe Skënderaj gjatë muajit Nëntor bien deri në 80mm reshje, të cilat i detyrohen shtrirjes së tyre në kushtet e një relievi kryesisht kodrinor.




Figura 4. Variacioni i reshjeve mesatare mujore 1961-1990,

1.4. Proceset Fiziko – Gjeologjike

Proceset fiziko – gjeologjike që shprehen në dukuritë e ndryshme të tyre, ndikojnë negativisht në sheshin e ndërtimit. Zhvillimi intensiv i tyre, në një shesh ndërtimi bënë shpesh herë që të hiqet dorë prej tij. (Konomi, 2006). Në studimin e fenomeneve gjeologjike të kësaj zone jam bazuar në studimet e mëherëshme dhe në informacionet e reja që kemi marrur nga studimi aktual. Bazuar në këto të dhëna po bëjmë përshkrimin e fenomeneve gjeologjike që janë prezente në formacionet gjeologjike që takohen në këtë zonë. Fenomenet më të dukshme gjeologjike që vërehen në këtë zonë janë:

- Fenomeni i përjarrimit
- Fenomeni i erozionit

Fenomeni i përjarrimit vërehet në formacionet kryesore që përbëhen nga ranorët, argjilitet. Këto formacione nën veprim të agentëve atmosferik transformohet nga shkëmbinjë të butë në dhera. Ky fenomen takohet në kodra e zhveshura përreth.

Fenomeni i erozionit është i dukshëm në kodrat përreth zonës. Gjatë periudhave të reshjeve, ujërat sipërfaqësore erodojnë formacionet e alteruara dhe transportojnë materiale në pikat më të ulëta të relievit. Ky fenomen është natyral dhe vërehet në fundin e pjerrtësirave të kodrave përreth. Bazuar në hartën e erozionit të Kosovës, lokacioni i hulumtuar përfshihet në zonën me **erozion mesatar**.




Figura 5. Harta e erozionit të Kosovës

2.0. NDËRTIMI GJEOLIGO – TEKTONIK

Ndërtimi gjeologo - tektonik është një nga faktorët më të rëndësishëm, që ndikon në vlerësimin gjeologo – inxhinierik të sheshit të ndërtimit. Ai pasqyrohet në kushtet e shtrirjes së shtresave, veçoritë litologjike të tyre dhe praninë e prishjeve tektonike shkëputëse. Shtrirja e shtresave brenda sferës së ndikimit inxhinierik mund të shkaktojë ulje - diferenciale në objekte kur këto të fundit nën themelet e tyre dhe brenda zonës aktive kanë shtresa me trashësi dhe veti fiziko – mekanike të ndryshme (Konomi, 2006). Në aspektin tektono – stratigrafik, zona e studimit shtrihet në mes të njësisë së Drenicës dhe Njësisë së Jashtme të Vardarit, gjë që shihet edhe nga harta tektono – stratigrafike tek figura 6. Në vazhdim janë paraqitur Njësitë tektono – stratigrafike në të cilat bënë pjesë zona e studimit.

Njësia e Drenicës (ND) – Veçohet për herë të parë si Njësi më vete. Përhapet në pjesën qendrore të Kosovës dhe në gjithë buzën perëndimore të Njësisë së Përbërë të Vardarit. (Elezaj&Kodra, 2008).

Në kontekstin paleotektonik, Njësia e Drenicës përfaqëson basen – shpatin perëndimor të basenit oqeanik të Vardarit. Ndërsa, në drejtimin lindor, ajo kufizohet me Njësinë e Përbërë të Vardarit, në drejtimin perëndimor kufizohet me dy njësitë platformike Peja dhe Radusha, përkatësisht në Veri dhe në Jug, dhe me Njësinë e Malishevës, në qendër të Kosovës. Ndërtohet nga formacione paleozoike të facies Kulm (Karbonifer), formacione “Hallstat” të moshës Triasiko – Jurasike, kryesisht karbonato – silicore dhe rrallë mbi to slicorë radiolaritikë të Jurasikut të Mesëm dhe shiste me blloqe të Jurasikut të Mesëm – të Sipërm. Formacionet paleozoike dhe Triasiko – Jurasike, mbulohen me mospajtim nga formacioni flishor Volljaku (J–K1) dhe gëlqerorë e flishë të Kretakut të Sipërm. Molasat oligo – miocenike dhe magmatizmi dacito – andezitik etj., takohen në pjesën veriore të Njësisë.

Njësia e përbërë e Vardarit (NPV) - Është pjesë qendrore e Njësisë së madhe të Vardarit, me shtrirje dinarike për qindra kilometra nga deti Egje në jug, deri në pellgun e Panonit në veri. (Elezaj&Kodra, 2008). Në lindje kontakton tektonikisht me Masivin Dardan, ndërsa në perëndim braniset mbi Njësinë e Drenicës. Njësia e Përbërë e Vardarit është Njësia me e rëndësishme metalogjenike e Kosovës. Studiuesit e Njësisë së Përbërë të Vardarit e ndajnë

atë në tri njësi: Njësia e Jashtme (NJV), Njësia Qendrore (NQV) dhe Njësia e Brendshme (NBV). Karakteristikë e Njesisë së Përbërë të Vardarit është prania e madhe e ofioliteve, si dhe ndërtimi i ndërlikuar i saj, si rezultat i përfshirjes së formacioneve në pyka të akrecionit oqeanik, gjatë mbylljes së basenit oqeanik të Vardarit. Mbulesa e Jurasikut të Sipërm dhe veçanërisht ajo kretake, është mjaft e përhapur. Molasat oligo – miocenike, shoqëruar me një magmatizëm intruziv dacito – andezitik dhe riolitik, përbëjnë një tjetër tipar dallues të Njesisë së Përbërë të Vardarit. Molasat pliocenike dhe mbulesat e Holocen – Pleistocenit zënë sipërfaqe të konsiderueshme.




Figura 6. Harta tektono - stratigrafike e Kosovës (Elezaj&Kodra, 2008)

2.1. Karakteristikat tektonike të Kosovës

Territori i Kosovës bënë pjesë në brezin e rrudhosur Alpin, në segmentin perëndimor të Mesdheut Lindor. Strukturat e Kosovës inkuadrohen, kryesisht, në harkun Dinarido – Albanido – Helenid dhe vetëm cepi lindor i Kosovës inkuadrohet në harkun Alpido – Karpato – Ballkanik. Infleksioni kryesor i strukturave të Dinarido – Albanido – Helenid kryhet pikërisht në pjesën qendrore – perëndimore të Kosovës, që i përgjigjet brezit tërthor Shkodër – Pejë. është i prerë nga struktura tektonike longitudinale dhe transversale të cilat ndajnë njësiti gjeotektonike. Kriteri gjeologjik është i lidhur me proceset që janë zhvilluar gjatë etapës neotektonike kur janë formuar morfostrukturat kryesore në relievin e sotëm. Këto procese janë vazhdimësi e stadeve të hershme neotektonike dhe për këtë arsye shërbejnë si të dhëna të besueshme për parashikimin e vendit dhe forcës së tërmeteve të ardhshme. (Elezaj&Kodra, 2008).

Njësia e Drenicës – përhapet në trajtë të një “brezi” 15-25km të gjerë, përgjatë buzës perëndimore të Njesisë së Jashtme të Vardarit. Kufiri tektonik mes tyre kalon afërsisht sipas drejtimit Mitrovicë në perëndim të Çiçavicës(përgjatë zonës së studimit), Shtimes, Ferizajit e Kaçanikut. Njësia e Drenicës përfaqëson basen – shpatin perëndimor të Basenit Oqeanik të Vardarit. Stili tektonik i Njesisë së Vardarit është tepër i ngjashëm me atë të Vardarit. Formacionet kanë shtrirje lineare Veri Perëndim – Jug Lindje dhe rënie të fortë Lindje – Verilindje. (Elezaj&Kodra, 2008). Shkëputjet aktive në etapën neotektonike sot përfaqësojnë kufijtë natyralë midis blloqeve me tendencë në ngritje dhe ultësirave me tendencë në zhytje, midis horsteve dhe grabeneve. Ato kanë karakter të shkëputjeve normale me kënd rënie të madh nga ngritjet drejt depresioneve, morfostrukturave me tendencë mbizotëruese në zhytje. Veçimi i shkëputjeve dhe klasifikimi i tyre sipas manifestimit të tyre në terren janë pasqyruar në **Figurën 7**, e cila në detaje evidenton shkëputjet tektonike aktive të paraqitura me numra nga 1 deri 26, që komplikojnë strukturën e re neotektonike të Kosovës, sipas (Elezaj, 2002). Bazuar në hartën e shkëputjeve neotektonike, zona e studimit shtrihet përgjatë shkëputjes 23 Prishtinë – Drenas, shkëputje kjo që përfaqëson shkëputje të imagjinuara.




Figura 7. Harta e shkëputjeve neotektonike të Kosovës, (Elezaj&Kodra, 2008)

Gjatë etapës neotektonike, territori i Kosovës është përfshirë nga proceset tektonike, të cilat kanë kushtëzuar formimin e njësive të reja morfostrukturore: morfostrukturat me tendencë mbizotruese në ngritje dhe në zhytje.

Në kuadrin e përgjithshëm morfotektonik e morfologjik gjithë zona e Drenicës përfaqëson një prag strukturor horstik, i cili është diferencuar nga tektonika e re Pliocen – Kuaternare prej dy fushave grabenore ndërmallore më të mëdha të Kosovës, pra Fushës së Kosovës në verilindje dhe asaj të Rrafshit të Dukagjinit nga jugperëndimi. (Nuli, 2017)

Bazuar në hartën morfostrukturore të Kosovës, në figurën 8, trevat me tendencë mbizotëruese në ngritje janë ndarë në blloqe të veçanta, të emërtuara me numra, nga 1 deri 13, ku zona e studimit i takon bllokut B-8 me tendencë mbizotëruese në ngritje më të ulët.




Figura 8. Harta morfostrukturore e Kosovës (Elezaj&Kodra, 2008)

2.1.2. Sizmiciteti i territorit të Kosovës

Territori i Kosovës nga aspekti sizmotektonik përfaqëson një teren mjaft aktiv, në të cilën mund të priten tërmete katastrofike me karakter autokton. Të dhënat nga katalogu i tërmeteve dëshmojnë qartë se dukuria e tërmeteve katastrofike në disa pjesë të territorit të Kosovës ka qenë evidente shumë herët. Si tërmete historike përmendim disa: Tërmeti i Prizrenit në vitin 1456 me intensitet IX ballë, pastaj tërmeti i Pejës në vitin 1662 me intensitet VIII, në vitin 1921 tërmeti i Ferizajit – Viti – Gjilan me intensitet IX, e shumë tjerë deri te ky i fundit i cili ndodhi me 24.04.2002 në Gjilan me intensitet VII ballë duke u bazuar në katalogun e tërmeteve, karakteristikat tektoniko-strukturore, strukturat neotektonike, rajonet që më së shumti janë prek nga tërmetet, në territorin e Kosovës ka disa zona të fuqishme të burimeve sizmike, ose zona sizmogjene, të cilat janë:

1-Zona sizmogjene Prizren – Pejë;

2-Zona sizmogjene Ferizaj – Viti – Gjilan;

3-Zona sizmogjene Albanik(Kopaonik).

Këto zona sizmogjene apo këto burime sizmike në Kosovë kanë gjeneruar në të kaluarën dhe mund të gjenerojnë edhe në të ardhmen tërmete të forta. Harta e burimeve sizmike në Kosovë është përpiluar duke u bazuar në katalogjet e tërmeteve ose në hartën epiqendrore duke i rrethuar disa zona epiqendrore me kufinjë, në të cilat në aspektin hapësinor tregohen burime sizmogjene. Nga figura 9, ku është e paraqitur harta e burimeve sizmogjene kuptojmë se përcakton pozitën, orientimin dhe madhësitë e burimeve sizmogjene. (Elezaj, 2002).




Figura 9. Harta e nxitimit maksimal në territorin e Kosovës. (Elezaj&Kodra, 2008)

2.1.3. Karakteristikat e përgjithshme dhe kushtet mesatare të truallit në Kosovë

Për përpilimin e hartës së rrezikut sizmik të Kosovës të gjitha të dhënat inxhinierike mbi dukuritë e tërmeteve në sipërfaqen e tokës duhet të sillen gjithësesi në kushte të njëjta trualli për gjithë territorin. Kushtet e truallit ndikojnë intensitetin lokal të tërmetit dhe kjo është arsyeja pse duhen marrë në konsideratë. Kushte të tilla trualli tek ne përbëjnë depozitimet e shkriфта potente me nivel të thellë (poshtë 5 m nga sipërfaqja e tokës) të ujërave të truallit: rëra, surëra, argjila, suargjila e zhavore, mbi të cilat vendosen qendra të mëdha të banuara, siç janë pjesa me e madhe e qyteteve, shkëmbinjtë e fortë dhe gjysëm të fortë me reliev të diferencuar, me të cilat tipare karakterizohet pjesa me e madhe e fshatrave, ku për territorin e Kosovës janë shquar disa kategori trojesh, që paraqesin influencë të ndryshme në intensitetin e tërmeteve: Shkëmbinjë të fortë, Shkëmbinjë të fortë dhe gjysëm të fortë, depozitime të shkriфта me nivel të thellë (poshtë 5m nga sipërfaqja e tokës) të ujërave të truallit, depozitime të shkriфта me nivel të cekët (mbi 5m nga sipërfaqja e tokës) të ujërave të truallit, depozitime të shkriфта me nivel pranë sipërfaqes të ujërave të truallit e me mundësi lëngëzimi.

2.1.4. Rajonizimi sizmik i Kosovës

Për të pasqyruar prognozën e lëkundjeve të sipërfaqes së tokës dhe ligjshmërinë e shuarjes së intensitetit epiqendror për qëllime praktike, ndërtohet harta e rajonizimit sizmik të tij. Për ndërtimin e hartës së një trualli të caktuar merren parasysh disa elemente: ndërtimi gjeologjik i rajonit, (thyerjet tektonike gjatë dhe kryq strukturave, nyjet e ndërprerjes së tyre dhe shkëputjet e reja tektonike), vetitë fiziko – mekanike të truallit dhe të dhënat nga katalogu i tërmeteve.

Sizmiciteti i një rajoni përfaqëson karakteristikat e tërmeteve që përcjellin zhvillimet e reja tektonike të rajonit. Vlerësimi i rrezikut sizmik është bërë sot në botë një drejtim i preferuar i sizmologjisë. Termi rrezik sizmik nënkupton mundësin potenciale të tronditjes së truallit nga tërmetet maksimale të mundshëm. Sot në botë përdoret llogaritja probabilitare për vlerësimin e rrezikut sizmik, si më poshtë shënuar.

Për vlerësimin e rrezikshmërisë sizmike të truallit merren parasysh shumë faktorë: ndërtimi gjeologjik i truallit, kontakti dhe shtrirja në mes shkëmbinjëve, shkëputjet tektonike, këndi i

rënjës së truallit etj. Ndërtimi gjeologjik i truallit është një faktor me rëndësi për vlerësimin e rrezikut sizmik, sepse intensiteti i tërmetit nuk është i njëjtë në shkëmbinjët e ndryshëm si shembull marrim disa: (Xh.Kurti).

Rritja e shkallës së sizmicitetit për kategoritë e shkëmbinjëve të truallit:

- Në shkëmbinjët granit 0
- Në shkëmbinjët mergelorë, gipse 0 - 1
- Në shkëmbinjët argjilla 1 - 1.5
- Në shkëmbinjët materiale të mbledhura 1.5 - 2.5

Intensiteti i tërmetit ulet apo ngritet varësisht nga kontakti i llojeve të shkëmbinjëve nëpër të cilët lëvizin valët sizmike, prandaj në **figurën 10**, është paraqitur kontakti i llojeve të ndryshëm të shkëmbinjëve, nëpër të cilët lëvizin valët sizmike.




Figura 10. Kontakti i llojeve të shkëmbinjëve nëpër të cilët lëvizin valët sizmike. (Xh.Kurti)

2.2. Përbërja Litostratigrafike e zonës

Në zonën e studiuar, duke u bazuar në hartën 1:100 000 të Kosovës, përhapen formacione gjeologjike që u takojnë të moshave të ndryshme, të cilat janë prezantuar në vazhdim:

Paleozoiku (Pz) - Formacionet e Paleozoikut të Sipërm përhapen në pjesën jugore të zonës. Formacionet gjeologjike të Paleozoikut janë të larmishme dhe përfaqësohen nga: Pararreshpjet, filitet, rreshpjet sericitike, metaranorët, gëlqerorët dhe nga konglomeratet. Formacionet e Paleozoikut janë intensivisht të rudhosura dhe shfaqin sjellje të diferencuar ndaj sforcimeve tektonike, ku formacionet kompetente rudhosen, ndërsa ato inkompetente thyhen tektonikisht. ((IH)"Jarosllav Černi", 1983).

Triasiku (T) - Formacionet e Triasikut janë të përhapura përreth zonës së studimit, si në pjesën perëndimore, veriore e lindore. Triasiku përfaqësohet kryesisht nga: Gëlqerorë të mermerizuar, dolomite, kuarcite, amfibolite, metaranorë, metaargjilite. Në pjesën veriore ekzistojnë edhe formacione mergelorë dhe seria vullkanogjeno – sedimentare. Gëlqerorët janë tektonikisht të shaktërruar me çarje dhe plasa. ((IH)"Jarosllav Černi", 1983) Dendësia e rrjetit të çarjeve nganjëherë favorizon proceset e erozionit dhe karstit të cilat nga ana e tyre, shërbejnë si rrugë për lëvizjen e ujërave nëntokësorë.

Jurasiku (J) – Formacionet e Jurasikut takohen në pjesën jugore të zonës (Masivi i Goleshit), dhe në pjesën perëndimore. Përfaqësohen nga: Serpentinitet, dunitet dhe harchburgitet e serpentinizuar. Tektonikisht janë mjaft të shkatërruara dhe të eroduara në sipërfaqe.

Kretaku (K) – Përfaqësohet nga gëlqerorët dhe flishet. Formacioni flishor përbëhet nga alevrolite, ranorë, gëlqerorë, mergelorë etj. Gëlqerorët janë kryesisht pllakorë dhe gëlqerorë rudist. Falë efekteve shkatërruese tektonike, ata kanë një sistem të zhvilluar plasaritjesh e çarjesh (Çadraku, 2014).

Neogjeni (N) – Formacionet e Miocenit dhe Pliocenit janë të zhvilluara kryesisht në pjesët periferike të zonës së studimit, duke pasur parasysh se zona e studimit gjendet në mes të basenit të drenicës, përkatësisht në anën perëndimore të basenit të Kosovës. Këto formacione përfaqësohen nga: Argjilat, rërat, zhavoret, mergelet, tufet e pjesërisht lignjitet.

Kuaternari (K) – Sedimentet e Kuaternarit kanë përhapje mjaft të gjerë në këtë zonë. Përfaqësohen nga: teracat e para e të dyta lumore, deluvionet, proluvionet dhe aluvionet. Bazuar në hartën gjeologjike të paraqitur në figurën 11, zona e studimit përbëhet nga: depozitimet deluviale (argjila, rëra dhe zhavore).

HARTA GJEOLGJIKE E ZONËS

LEGJENDA

Kuaternari

Holoceni

- aQh Aluvione
- pQh Proluvione
- dQh Deluvione

Pleistoceni

- gQp Zhavor, rërë

Teracat lumore

- tQp Teracat e para lumore
- dQp Teracat e dyta lumore

Neogjeni

Plioceni

- cNp¹ Argjilë, rërë, zhavor, mergele, pjesërisht lignjit

Mioceni

- mcNm²⁻³ Mergelore, argjilite, gëlqerorë, tufite, pjesërisht lignjit

Kretaku

Mastriktiani

- sKm Gëlqeror pllakor, argjilite, thjerrza silicore, flish ranorë

Santonian - Mastriktian

- lKs-m Gëlqeror rudist, brekçie, flish ranorë me olistolite

Cenomanina - Turoniani

- lKc-t Gëlqerorë rudist me orbitolina
- sKc-t Gëlqerorë mergelorë, ranorë,

Triasiku

Anisani

- cTa Gëlqerorë silicor të mermerizuar
- kT1-2 Kuarcite, metakuarcite-ranorë, konglomerate
- AT1-2 Amfibolite
- qT1-2 Mika kuarcite, meta ranorë, meta argjilite

Paleozoiku i Sipërm

- pPZ2 Pararreshpe(filite, rreshpe sericitike, meta ranorë, pjesërisht kalkshiste)

Ngjarjet e Jurasikut(J. i Mesëm - Sipërm)

- vsJ2-3 Seria Vullkano - Sedimentare
- sJ2-3 Peridomite të serpentinizuara (harchburgite të serpentizuara)
- sJ2-3 Serpentinite

Ngjarjet e Triasikut (Triasiku i Mesëm)

- vsT2 Seria Vullkano - sedimentare

Kufijtë Gjeologjik

- Kufi gjeologjik, i vëzhguar
- Kufi gjeologjik, i paraqitur
- Kufi litologjik, i pa definuar

Tektonika


- Shkëputje, e vëzhguar
- Shkëputje, e paraqitur
- Këndi i rënies së anuklinales, sinklinales

Shpimet

- Shpim i veçantë
- Grup i shpimeve

Topografia

- Zona të ndërtuara (qytete, fshatra, etj)
- Rrugët
- Rrugët regjionale
- Autostradat
- Hekurudhat
- Rezervarë uji
- Lumenjët
- Kufiri Administrativ



0 1,000 2,000 4,000 6,000 8,000 10,000 metra

Shkalla 1 : 100,000

2.3. Kushtet hidrogeologjike të zonës

Kushtet hidrogeologjike të sheshit të ndërtimit shprehen me karakterin dhe shkallën e ndryshimit të vetive fiziko – mekanike të shkëmbinjëve nën veprimin e ujërve nëntokësorë dhe me mundësinë e lindjes së proceseve fiziko – gjeologjike si të: (karstit, rrëshiqtjeve, lëngzimit etj.), pastaj me agresivitetin e ujërave nëntokësorë, kapilaritetin dhe zbutjen e pjesëve të ndryshme të bazës së objekteve inxhinerike nga ngritja e nivelit të ujërave nëntokësore. (Konomi, 2006).

Sa i përket hidrogeologjisë së zonës së studimit kam shfrytëzuar të gjitha punimet ekzistuese dhe punimet e tanishme, dhe rezulton se shtresat e takuara në zonën e studimit janë Deluvione të përfaqësuara nga zhavoret, rërat, pluhuri e argjila të cilat janë ujëmbajtëse dhe se niveli i ujit nëntokësorë takohet kryesisht në shtresat granulare me porozitet mesatar deri të lartë. Karakteri artezian i zonës i detyrohet vendosjes së shtresave ujëmbajtëse midis dy shtresave të papërshkueshme (Konomi, 2006), pjerrësisë të shtresave ujëmbajtëse dhe vendosjes së zonës së ushqimit në lartësi mbidetare sipër zonës së drenimit.

Bazuar në hartën hidrogeologjike të zonës të parqitur në figurën 12, mund të theksohet se zona e hulumtuar gjindet në akuifer me porozitet intergranular. Permeabiliteti i kësaj zone sillet mes 10^{-9} deri 10^{-5} m/s. Zona është kryesisht e përbërë nga argjila, pluhuri, rëra, dhe zhavori.

Legjenda

Akuifer

Poroz / porozitet intergranular

- Akuifer me porozitet intergranular dhe me ujëpërshkueshmëri mesatare - deri të lartë(rërë + zhavorr, rërë + zhavorr + pluhur)
- Akufier me porozitet intergranular me pak deri mesatarisht ujëpërshkueshmëri (argjilë+rërë+pluhur)

Poroziteti çarës

- Akuifer me porozitet çarës me ujëpërshkueshmëri të çarjeve të ulët - mesatar (gëlqerorë, mermere, shk. metamorfik, shk intruziv

Porozitet çarës / kastfikikuar

- Akuifer me porozitet çarës dhe të karstifikuar kryesisht i alteruar, ujëpërshkueshmeri çarës (gëlqerorë, mermere)
- Akufiere me porozitet çarës ose porozitet intergranular të pa konsiderushëm(psh ranorë, konglomerate, mudstone, siltstone, shk. metamorfikë, shk. vullkanik, shk. intruzivë

Zona e alterimit tektonik / hidrotermal

- Zona e alterimit të shkëmbinjëve të fortë me ujëpërshkueshmëri të ulët -mesatar

Të dhëna mbi ujërat nëntokësorë

- Drejtimi i rrjedhjes së ujërave nëntokësorë, i plotë
- Drejtimi i rrjedhjes së ujërave nëntokësorë, pjesë - pjesë
- Zonë me ujëra artezian të mbyllur

Të dhënat tektonike

- i plotë, pjesë-pjesë
- Shkëputje, karakteristika hidrogeologjike të panjohura
- shkëputie

Litologjia

Shk. të pakonsoliduar

Sedimente

- Rërë
- Rërë + zhavorr
- Rërë + zhavorr + pluhur
- Argjilë + rërë + pluhur

Shk. Magmatik dhe metmaorfikë

- Shk. intruzivë
- Shk. vullkanikë
- Shk. piroklastikë
- Shk. metamorfikë
- Mermere

Shk. të konsoliduar

Shk. sedimentarë

- Kongolmerate
- Ranorë
- Ranorë + konglomerate + mermere
- Argjilte + Ranorë + Mermere
- Gëlqerorë / mermere
- Gëlqerorë

Ujërat Sipërfaqësorë

- Liqen
- Lum kryesor
- Degë lumi
- Uji sipërfaqësor ndan lumin kryesor
- Uji sipërfaqësor ndan degën e lumit


Pikat primare

- Pus shpimi
- Grup i puseve të shpimit
- Pikë vrojtimi, monitorimi, piezometer
- Pikë mostrimi
- Pikë pumpimi


Të dhënat topografike

- Kufiri administrativ
- Qytetet
- Rrugët
- Hekurudha

HARTA HIDROGJEOLOGJIKE E ZONËS



Shkalla 1:200,000



Të dhënat mbi burimet

i vogël <10 l/s	mesatar 10-100 l/s	madh >100 l/s	i pa klasifikuar
			Burim jo aktiv
			Burim aktiv
			Burim mineral (>1 g/l) jo aktiv
			Burim mineral (>1 g/l) aktiv

3.0. PUNIMET GJEOLIGO – ZBULUESE

Për të studiuar zonën për ndërtimin e stadiumit nacional dhe për të vlerësuar gjendjen e formacioneve gjeologjike dhe karakteristikave fiziko – mekanike janë realizuar 11 shpime hulumtuese të përcjellura nga teste (SPT) në pusin e shpimit, pastaj janë realizuar në hapësirën ndërmjet shpimeve 8 teste (CPTu) dhe një studim seizmik me metodën e valëve të thyera. Në **figurën 13**, është paraqitur situacioni i shpimeve dhe testeve CPTu.

3.1. Qëllimi i punimeve gjeologo – zbuluese

Në fazën e punimeve gjeologo – zbuluese, destinacion kryesor ka qenë përcaktimin e karakteristikave të formacioneve gjeologjike në zonën e planifikuar për ndërtimin e stadiumit nacional. Marrja e kampioneve me strukturë të prishur dhe të paprishur për shqyrtim të mëtejme në laborator kanë qenë prioritet, pastaj rëndësi i është kushtuar testeve “in-situ”: testit të penetrimit standard(SPT) dhe testit të penetrimit të konit me presion poror(CPTu). Në këtë fazë është realizuar edhe studimi seizmik me metodën e valëve të thyera. Në nënkapitujt në vazhdim do të njihemi hollësisht me të gjitha punimet gjeologo – zbuluese të lartë cekura.

3.2. Zhvillimi i punimeve gjeologo – zbuluese dhe kontrolli i tyre

